

VENDIM
Nr. 235, datë 27.3.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA BASHKIA KORÇË TEK
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË, TË OBJEKTIT BAZA PRODHUESE E SHKOLLËS
SË MESME BUJQËSORE “IRAKLI TEROVA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 82 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Baza prodhuese”, së bashku me truallin nën objekt, që ndodhet brenda territorit të shkollës së mesme bujqësore “Irakli Terova”, Korçë, nga bashkia Korçë tek Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, sipas planimetrive dhe planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkia Korçë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë dhe shkolla e mesme bujqësore “Irakli Terova”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha